



Funded by
the European Union



E drejta për pushim të lehonisë dhe pushim prindëror

Kohëzgjatja e pushimit të lehonisë

Sipas Ligjit të Punës, me rastin e lindjes së fëmijës, nënat kanë të drejtë në pushim të lehonisë deri në 12 muaj ndërsa baballarët kanë të drejtë në 2 ditë pushim me pagesë dhe 2 javë pushim pa pagesë. Pushimi i lehonisë është i ndarë si në vijim:

- ✓ 6 muajt e parë paguhen nga punëdhënësi me 70% të pagës bazë.
- ✓ 3 muajt e ardhshëm paguhen nga Qeveria me 50% të pagës mesatare në Kosovë.
- ✓ 3 muajt e fundit janë pa pagesë, nëse nëna zgjedh t'i shfrytëzojë.

E drejta për 3 muaj pushim të paguar nga Qeveria dhe 3 muaj pushim pa pagesë mund të barten te babai i fëmijës në marrëveshje me nënën.

Gratë shtatzënë kanë të drejtë të fillojnë pushimin e lehonisë deri në 45 ditë para datës kur pritet të lindin, me prezantimin e certifikatës mjekësore. Njëkohësisht, në marrëveshje me punëtoreshen që është shtatzënë, punëdhënësi ka të drejtë të kërkojë fillimin e pushimit të lehonisë në periudhën prej 28 ditëve para datës kur pritet të lindë, në rast se vlerëson se ajo nuk është në gjendje t'i kryejë detyrat e saj.

Mbrojtjet e garantuara me ligj

Gjatë kohës së shtatzënisë, pushimit të lehonisë, dhe rikthimit në punë pas pushimit, punëdhënësi **nuk mund**:

- X T'ia shkëpusë kontratën punëtore dhe t'ia ndërrojë vendin e punës.
- X Ta sistemojë punëtoreshen jashtë vendbanimit të saj, pa pëlqimin e saj, deri sa fëmija t'i mbushë 3 vjeç. Kjo vlenë edhe për prind të vetëm deri sa fëmija t'i bëjë 5 vjeç dhe për prindër të fëmijëve me pengesa të rënda në zhvillim.
- X Ta obligojë punëtoreshen të punojë më gjatë se orari i rregullt i punës dhe punë gjatë natës deri sa fëmija t'i mbushë 3 vjeç. Në rast se fëmija ka aftësi të kufizuara të përhershme, pas përfundimit të pushimit të lehonisë, njëri prej prindërve ka të drejtë të punojë me gjysmë orari deri sa fëmija t'i mbushë 2 vjet.
- X T'i caktojë punë që është e përcaktuar si e dëmshme për shëndetin e nënës apo të fëmijës, veçanërisht nëse e punësuar është shtatzënë apo gjdhënëse.

Përkujdesja e fëmijës

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Ushqyerit me Qumësht Gjiri, çdo e punësuar që e ushqen foshnjën me gji ka të drejtë:

- ✓ Pushim pa pagesë për 2 orë në ditë për gjdhënie, në periudhën prej 6 muaj deri 1 vit të foshnjës, nëse ajo zgjedh të mos e përdorë 6 mujorin e dytë të pushimit të lehonisë.
- ✓ Pushim pa pagesë për 1 orë në ditë për gjdhënie, pas përfundimit të pushimit të lehonisë, në periudhën prej 1 deri 2 vjet të foshnjës.

Ky pushim është shtesë e pushimit të rregullt gjatë orarit të punës, dhe mund të shfrytëzohet në fillim, në mes, apo përfundim të orarit të punës, në marrëveshje me punëdhënësin.